

STATUTI dhe AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"FELICIS" Sh.p.k

KREU 1

DEPOZITA TE PERGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

NENI 1

a. Sot ne Tirane ne daten 18.06.2024 themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "FELICIS" Sh.P.K, me vullnetin e lire te ortakeve, ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", formohet shoqeria me pergjigjesi te kufizuar "FELICIS" sh.p.k, nga ortakel themelues:

1. Znj. Ronilda Kola lindur më 29.03.2005 në Tiranë, me nr. Pasaporte K55329031B lëshuar më 15.12.2021 e vlefshme deri më 14.12.2031, me adrese në: Rr. Karl Gega, madhore me zotesi te plote per te verpuar pa pengesa ligjore nënshkruan statutin si mëposhte vijon:

b. Te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kane vendosur te destinojne ne kete sipermarrje kapitalin e tyre, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria e Shoqerise, si dhe te perballoje hurnbje deri ne kufirin vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.

c. Shoqeria ushtron veprimtarrne e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire. Shoqeria Tregtare "FELICIS" shpk, fiton Personalitetin Juridik nga dita e regjistrimit e saj pranë zyres se Qendres Kombetare te biznesit.

FORMA DHE EMERTËMI I SHOQERISE

NENI 2

1. Shoqerra tregtare, eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me Pergjigjesi te Kufizuar.
2. Emërtimi I shoqerise eshte: "FELICIS" Sh.p.k
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare, rruund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.



SELIA E SHOQËRISË
NENI 3

1. Shoqëria tregtare "FELICIS" Sh.P.K, e ka selinë qendrore ne territorin e republikes se Shqiperise ne qytetin e Tiranes, Njesia Bashkiake nr.5 Rr."Nikolla Tupe", Nr 27.
2. Shoqëria mund te krijoje qendra sekondare, filial, zyra perfaqesimi apo agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
3. Ajo mund te jete pjesemarrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise . Njesia strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjilaconin shqipetar kur ndodhen brenda territorit te Republike se Shqiperise, dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e tij

KOHËZGJATJA
NENI 4

1. Shoqëria tregtare "FELICIS" Sh.P.K, do te permbushe objektin e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqerise duke perfs hire dhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti te ri Juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE
NENI 5

Objekti i shoqerise "FELICIS" Sh.P.K dote jete:

Shoqëria ka për objekt social - Ushtrim i veprimtarise se ndermjetesimit ne tregun e punes ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Konsulence ne tregun e punes per kedo te afte dhe te gatshem per te punuar. Organizimi i takimeve me bizneset qe ofrojne pozicione vakante apo me individet qe duan te ofrohen ne tregun e punes .Sherbimi do te ofrohet kryesisht online nga çebsite ose nga aplikacioni , por gjithashtu do te jene te mundshme dhe takimet fizike prane ambijenteve tona.

TE DREJTA TE SHOQERISE
NENI 6

Shoqëria tregtare "FELICIS" Sh.P.K, nuk përgjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industrial qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj. Shoqëria mund te ndryshoje emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarise, administratorin sipas vendimeve qe do te marrin ortaket.



KAPITALI I SHOQËRISË NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 200.000 leke (dyqind mije leke), i cili eshte teresisht Kapital financiar. Kapitali themeltar eshte kuote me vlere nominale 200.000 leke.

Kaitali themeltar zoterohet nga:

1. Znj.Ronilda Kola , zoterues i 1 (nje) kuote apo 100% te kapitalit te shoqerise.
Ortaket kane te drejte te tjetersojne, te zmadhojne apo pakesojne kuotat e kapitalit deri ne kufinjte e percaktuara nga ligji. Kapitali fillestar nuk eshte paguar.

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera tt vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik tregtar.

NENI 9


- 1.Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi I cdo fondi te vecante percaktohen nga ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
- 2.Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe en pergjithesi cdo operacion financiar I saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe en mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

NENI 10

- 1.Shoqeria tregtare "FELICIS" Sh.P.K, eshte pronarne pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
 - 2.Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
- Te gjitha shpenzimet per ushtrirnin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerisë

NENI 11

- 1.Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
- 2.Aktiviteti financiar I shoqerise do te mbyllet rne 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
- 3.Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga Ortaket dhe nese e kerkon ligji nga eksperti kontabel I autorizuar miratohen me Vendim te ortakeve te saj.



NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe aim und te kete pasuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi I kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne para dhe ne natyre apo I zvogelimi I tij behet me Vendimin e Ortakeve te shoqerise mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga ekonomisti I firmesose kontabli I miratuar.

KREU I DYTE

ORTAKERIA


NENI 16

Ortaket e shoqerise tregtare "FELICIS" Sh.P K, gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise, ne Aktin e themelimit dhe ne Statutin e Shoqerisë.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakevc.

NENI 17

1. Te marre pjese ne mbledhje e Asamblese se ortakeve duke ushtruar te drejten e votes se tij;
2. Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administnmin e shoqerise ndaj administratorit;
3. Te informohet mbi perrnbajtjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te fitimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Te perfitoje nga fitimi I shoqerise
5. Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara:



KREU I TRETË
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE
NENI 18

1.Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise, asambleja e ortakeve emerone dhe puneson administrator dhe drejtues teknik, te cilet qendrojne ne detyre deri sa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori I emeruar I ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji I jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Adminstratori i Shoqerise eshte:

Znj. RONILDA KOLA lindur më 29.03.2005 me nr. Pasaporte K55329031B lëshuar më 15.12.2021 e vlefshme deri më 14.12.2031, me adrese në Rr. Karl Gega, , e cili do të ushtrojë të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqerisë duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konform me ligjet e Republikës së Shqipërisë

- 1.Administratori emërohet për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqerise ne QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur nëse asambleja e pergjithshme nuk vendos që ta shkarkojë atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandate ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji
- 2.Administratori mund ti delegeje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
- 3.Shoqeria ne te ardhmen mund te administrohet dhe nga nje administrator tjetet, I cili emerohet me vendim te Ortakeve.

ASAMBLEJA
NEN 19

- 1.Asambleja e ortakeve eshte organi me I larte vendimmarres I shoqerise.
2. Ortaket mund t'i delegejne kompetencat e tyre me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
- 3.Cdo klauzole e kunder eshte e pavlefshme ne kete rast.

NENI 20

Asanmbleja e ortakeve ka te drejte:

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne Statut;
2. Te miratoje bilancin vjelor te shoqerise
3. Te vendose per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
4. Te emeroje rJhe shkarkoje administratorin e shoqerise;
5. Te shpalle prishjen, likuidimin dhe falimentimin e sl iqerise;
6. Te shprehet per kohezgjaljen e shoqerise;
7. Te miratoje marreveshjet e arritura ne qarkullimin civil te saj;
8. Te miratoje strukturat e shoqerise elj;
9. Cdo vendim tjetet qe I njihet nga ligji, Akti I Themelimit te shoqerise dhe Statutit te saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.



TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT
NENI 21

Administratori ka keto le drejta:

1. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet e saj me te tretet, e ne administraten publike;
2. Te emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe I nevojitet asaj ne permbushjen e aktivitetit treglar dhe ekonomik;
3. Te paraqese per miratim ne Asamblene I Ortakeve strukturen e brendshme organizative ,e shoqerise me emra perkates dhe te permbushe te gjilha detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni I punes Republikes se Shqiperise;
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise Brenda kufinjve te caktuara nga Asambleja e Ortakeve;
5. Te testoje aftesite e punojesve ne administrate;
6. Te therrase Asamblene e ortakeve dhe te propozoje ceshtjet qe duhen analizuar;
7. Te hartoje objektivat e shoqerise per cdo vit pasuesdhe te vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga Vendimet e marra nga Ortaket;
8. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqese ato per miratim nga Asambleja e Ortakeve.

NENI 22

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per falje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 23

1. Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me ekonomist te licensuar dhe kur kerkohet nga ligji me nje ekspert kontabel te autorizuar, te cilet jane pergjegjes per problemet qe mund te shkaktojne nga moskryerja ne rregull e detyres se tyre.
2. Per emerimin, kompetencat, detyrimet, pergjegjesitte, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 24

1. Te gjithhe personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi I tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me regjistrimin ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes se Juridiksionit ku ushtron akvitetin Shoqeria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punes, behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates e punes per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.



Mos marrevshje qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi nuk eshte I mundur palet i drejtohen Gjykates se rrethit Gjyqesor.

FORCA T MADHORE

NENI 25

Ortaket nuk mbajne pergjegjesi kur ka paaftesi paguese pjesore apo te plote per kryerjen e detyrimeve te tij kur kjo eshte si pasoje e rrethanave te forcave madhore qe vertetohen pas nenshkrimit te kontrates dhe ortaket nuk mund ti shmangen me masa te arsyeshme.

Ngjarje te forcave madhore jane ato qe I shpetojne kontrollit te ortakevc.

Kur ortaket ndodhen ne paaftesi te plotesojne detyrimet e tij per arsye te forcave madhore, ne baze te kontrates dhe statutit duhet te bejne cdo perpjekje qe ta kapercenje kete veshtiresi.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 26

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cdaredo shkak. Shoqeria mund te prishet para kohe;

- Me vendim te ortakeve
- Kur mbaron kohezgjatja e shoqerise;
- Pas dy vjeteve te veprimtarise me bilanc negative (humbje)
- Me vendim te gjykates ose per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

Ne rast mbyllje ortaket vendosin mbi menytrat e likujdimit dhe caktojne nje ose me shume likujdatore duke ju percaktuar dhe detyrat.

Ne rastin e likujdimit emertimi I shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "Shoqeri ne likujdim".

Mbasi behet njoftimi I mbylljes se likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqeria crregjistrohet nga regjistri tregtar I Qendres kombetare te Biznesit.

BAZA T LIGJORE

NENI 27

E gjithë veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ne pergjithesi ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise".

RUAJT JA E SEKRETIT

NENI 28

Ortaket detyrohen qe te mos nxjerrin tek te tretet te dhenat dhe njoftime sekrete qe kane te bejne me veprimtarine ekonomike te shoqerise.

Ortaket e shoqerise percaktojne llojin e te dhenave dhe informatave qe konsiderohen sekrete.



DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 29

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 30

Ky statut hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 31

1. Ky Statut perpilohet ne 3 (tre) kopje origjinale secili me te njejten vlere ligjore.
2. Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise;
3. Ky statut hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Ortaku I Vetem I shoqërisë

Znj. Ronilda KOLA

